

VENDIM
Nr. 368, datë 29.5.2019

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURISIT “TOKË BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”, TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 51/32, ZONA KADASTRALE 1914, BASHKIA SHIJAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 51/32, zona kadastrale 1914, Bashkia Shijak, sipas certifikatës së pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Durrës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 51/32, zona kadastrale 1914, Bashkia Shijak.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Këshilli i Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

Nr. Rend	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i Pasurisë	Sipërfaqja m ²	Sip që përdoret për zhvillim m ²	Sip ndërtimore m ²	Emërtimi i strukturës
1	Durrës	Shijak	1914	Guzaj	51/32	14075	3013.9	2348.6	Kapanon 1-2 kat, për përpunimin e frutave dhe perimeve.